



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 69 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27/06/2022

VENDIM
Nr.18, datë 27/06/2022

PËR

**PROJEKTIN E LINJËS ELEKTRIKE TË TENSIONIT TË LARTË NË DIGËN E
XHAFZOTAJ QË SHFRYTËZOHET NGA BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 27.06.2022 mori në shqyrtim kërkesën e OST për projektin e ndërtimit të linjës elektrike të TL në zonën e digës së Xhafzotaj. Në këtë mbledhje ishin prezent përfaqësues të Bashkisë Durrës dhe të OST. Përfaqësuesi i OST, informoi se projekti në këtë zonë është ndryshuar dhe në projektin e ri nuk është parashikuar asnjë shtyllë e tensionit të lartë në digën e Xhafzotaj. Gjithahstu, Ato informuan se një prej shtyllave është parashikuar të ndërtohet në zonën e ujëmbledhësit të Xhafzotaj në distancë mbi 30 m larg trupit të digës dhe linja elektrike që kalon mbi digë është llogaritur të jetë mbi 9 m mbi kreshtën e digës.

Gjatë diskutimeve të antarëve të KKDM u vu theksin se bazuar në legjislacionin e mësipërm, Shfrytëzuesi i digës dhe Ujëmbledhësit të Xhafzotaj (Bashkia Durrës) është përgjegjësi kryesor për sigurinë e digës dhe nënobjekteve të tjera që lidhen me të si dhe për pasojat që rrjedhin nga prishja ose aksidentet e mundshme në digë. Tërësia e masave organizative, teknike dhe financiare që merr shfrytëzuesi duhet të garantojnë shfrytëzimin normal të objektit, jetëgjatësinë e tij dhe mosçënimin e faktoreve që ndodhen në pjesën e poshtme të digës. Për rrjedhojë, Projekti duhet të marrë miratimin e Bashkisë Durrës. Gjithashtu, OST duhet të marrë përgjegjësinë çështjet që lidhen me sigurinë në punë të kësaj linje, sigurinë në punë gjatë difekteve që mund të ndodhin si dhe me respektimin e rregullores së shfrytëzimit të digës dhe ujëmbledhësit nga Bashkia Durrës. Njëkohësisht, për shkak të ndërhyrjes në ujëmbledhësin e Xhafzotaj, për kryerjen e këtij investimi duhet të merret miratimi nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU)

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Ti rekomandoj OST miratimin e projektit në fjalë tek Bashkia Durrës si shfrytëzuese e digës së Xhafzotaj si dhe kryerjen e një Oponence teknike për projektin e rishikuar. Njëkohësisht, OST duhet të informoj AMBU për kryerjen e këtij Investimi në këtë trup ujqor,
- 2- Ti kërktoj Bashkisë Durrës hartimin e një plani të shfrytëzimit të digës dhe ujëmbledhësit i cili duhet të jetë i detyrueshëm edhe për OST
- 3- Ti kërktoj Bashkisë Durrës, përgatitjen e Planit të emergjencave civile në rast të prurjeve maksimale në pellgun ujëmbledhës apo prishje të mundshme të digës. Në këtë plan duhet të përfshihet edhe harta e përmytjes në zonën urbane poshtë digës

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

